Kronikë

Arrestimi i Aldi Mustafës në Durrës, policia: Do kryente vrasje! Miku i 'Rrumit të Shijakut' do merrte hak për tritolin që i vendosën në muajin prill

Miku i Rumit të Shijakut, Aldi Mustafa është arrestuar mbrëmjen e të shtunës teksa po përgatitej të kryente një vrasje. Pa zbuluar objektivin, policia tha se në kërkim të objektivit, 37-vjeçari kishte lëvizur me armë në Durrës përgjatë dy ditëve të fundit. Mustafa donte të merrte hak për tritolin që i vendosën në muajin prill.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
1 Tetor, 11:25 | **Përditësimi: 1 Tetor, 13:48**

Share

DURRËS- Aldi Mustafa, pjesë e grupit të 'Rrumit të Shijakut', ***u arrestua*** një natë më parë (30 shtator) në Durrës, ndërsa lëvizte me armë me vete në makinë. Mustafa, një person me precedent të theksuar kriminal, kishte planifikuar një vrasje. Vetë policia, njofton se ai vënë në pranga ndërsa po shkonte për të vrarë dikë, por ende nuk dihet se kush ishte vënë në shënjestër. Bashkë me Mustafën, 37 vjeç, është vënë në pranga është bashkëpunëtori i tij Klevis Kurdiu, 27 vjeç, i cili po lëvizte në të njëjtën makinë me mikun e Aleksandër Lahos, njohur ndryshe si 'Rrumi i Shijakut'.

> *"Specialistët e Sektorit për Hetimin e Krimeve të Rëndа të DVP Durrës, falë inteligencës policore se një shtetas me precedent të theksuar kriminal po qarkullonte i armatosur dhe kishte planifikuar të kryente një vrasje, merjëherë kanë organizuar punën dhe në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale dhe 'Shqiponjat', kanë zhvilluar dhe finalizuar operacioninin policor të koduar "Tentativa". Si rezultat, në lagjen nr. 15, Durrës, shërbimet e Policisë kanë lokalizuar automjetin me të cilin lëvizte shtetasi i armatosur dhe kanë ndërhyrë duke zbatuar të gjitha procedurat standarde për ndalimin e një automjeti", njofton policia.*

LEXO EDHE:
Basha vijon turin e takimeve në Ndroq: Mirëpresim në PD të gjithë ata që duan një parti europiane

Report Tv mësoi se Aldi Mustafa, kishte 2 ditë që qarkullonte nëpër qytet me tentativë për të marrë hak për vendosjen e tritolit që i shpërthew na makinën e tij më 3 prill 2023. Grupi hetimor ende nuk e ka të paqartë se kush është objektivi, pasi ngjarja e ndodhur 6 muaj më parë ka mbetur e pazbardhur akoma. Para hetuesve, Aldi Mustafa nuk ka pranuar të japë deklarime ndërkohë që pritet dalja e tij në gjykatë për masën e sigurisë.

Arrestimi është realizuar të shtunën në lagjen nr. 15 në Durrës.Në momentin që është konstatuar nga uniformat blu, Mustafa ka tentuar të largohet me shpejtësi, por nuk ka mundur dot pasi është bllokuar nga shërbimet e Policisë. Ndërkohë në mjet ia gjet një armë zjarri "Scorpion" me silenciator dhe municion luftarak. Ai akuzohet për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, i armëve shpërthyese dhe municionit" dhe "Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësve të policisë".

Arrestimi i tij është përshëndetur edhe nga ministri i Brendshëm Taulant Balla.

> *"Falënderoj nga zemra forcat e Policisë së Shtetit, Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, Njësinë e saj Operacionale Shqiponjat te cilët arritën të parandalonin një ngjarje të rëndë kriminale, duke arrestuar një person me rrezikshmëri të lartë të armatosur", shkruan Balla.*

Kush është Aldi Mustafa?
Aldi Mustafa nuk është një emër i panjohur për policinë, pasi rezulton me precedentë të theksuar kriminal. Në ***3 prill të këtij viti***, persona ende të paidentifikuar shpërthyen me telekomandë makinën e Aldi Mustafës. 37-vjeçari doli i pa lënduar nga shpërthimi ndërsa pak minuta para se të ndodhte ngjarja, la në banesë gruan me fëmijën. Zona në të cilën ndodhi ngjarja kishte kamera të shumta sigurie, ndërsa Shqiptarja.com siguroi edhe ***videon e shpërthimit*** të mjetit. Aldi Mustafa, 37-vjeçar, njihet si një person me precedentë penal. Ai është arrestuar më 30 gusht të 2021 me dy të tjerë, pasi po planifikonin një vrasje. Aldi Mustafa rezulton i dënuar më parë me 10 vite burg në Gjermani, për veprat penale "Kanosja" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Ndërkohë me 30 dhjetor të vitit të kaluar, me vendim të gjykatës i është shuar masa e arrestit me kërkesë të tij. Ai ishte dënuar me 2 vjet burgim pas arrestimit në gusht 2021 për mosbindje të urdhrit të policisë, armëmbajtje pa leje dhe dëgjim të paregullt të mjetit. Mustafa më herët ka qenë anëtar i një bande të njohur në Durrës, ndërsa kohët e fundit ka pasur lidhje me Aleksandër Lahon i njohur si 'Rrumi', një personazh i përfolur në ngjarje kriminale, siç ishte dhe atentati ndaj ish-prokurorit Arjan Ndoja.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 13:14

U arrestua me armë gati për vrasje, Aldi Mustafa 'kyç' gojën para hetuesve! Do merrte hak për tritolin që i vendosën në prill të kërij viti

Aldi Mustafa, i arrestuar nga Policia e Durrësit me pistoletë me silenciator, kishte 2 ditë që qarkullonte nëpër qytet me tentativë për të marrë hak për sasinë e tritolit që i shpërthew na makinën e tij më 3 prill 2023. Grupi hetimor akoma e ka të paqartë se kush është objektivi i tij, pasi ngjarja e ndodhur 6 muaj më parë ka mbetur e pazbardhur akoma. Para hetuesve, Aldi Mustafa ka kyçur gojën dhe nuk ka deklaruar asnjë gjë, duke mbajtur mister për momentin që donte të vriste, që do të çonte rrjedhimisht *një zbardhje të tritolit që i shpëtoi mrekullisht.*

SI.E./Shqiptarja.com

Share

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: tentative vrasje | Klevis Kurdiu | aleksander lahoi | Durres | Aldi Mustafa | taulant balla

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A duhet që ndërkombëtarët të ushtrojnë më shumë presion ndaj Serbisë?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Durrës/ I shpërthyen makinën me tritol në prill të vitit, i bëhet ndjekje penale Aldi Mustafa, miku i Rrumit të Shijakut
30 Shtator, 19:50

VIDEO/ Propozim për martesë në ceremoninë e diplomimit, studentëja i thotë 'po' të riut në Durrës
30 Shtator, 16:54



Procesi i regjistrimit, Balla takim me përfaqësues të komunitetit shqiptar në Itali: Synimi i nismës, garantimi i së drejtës së votës
30 Shtator, 15:24

Beleri dërgon sërish kërkesë për t'u lejuar të bëjë betimin, vendimin do e marrë Gjykata e Durrësit
30 Shtator, 11:02

Balla në Ministerialin për 20 vjetorin e Konventës së Palermos: Droga po copëton shoqërinë tonë, po krijon terren për krimin
29 Shtator, 14:53

Policia Rrugore bën 'bilancin'! Në një javë u arrestuan 3 shoferë dhe u ndëshkuan me gjobë 1400 të tjerë
29 Shtator, 11:28

Basketboll/ Flamurtari i vajzave vendos 'diktatin', mund në finale Partizanin dhe ngre Kupën e Shqipërisë
29 Shtator, 10:31

Debate në Këshillin Bashkiak të Durrësit! Miratohet rritja e pagave për punonjësit e bashkisë! Opozita kundër: Të rritet cilësia e shërbimit

Aldo Mustafa

28 Shtator, 18:26

Vrasja e Fatjon Dervishit në Sukth, policia heton dy pista: Trafiku i narkotikëve dhe hakmarrja! Vëllai i 38-vjeçarit grabiti magazina droge në Spanjë
28 Shtator, 13:27

Basketboll/ Besëlidhja dominon Partizanin, Tirana kalon Kamzën! Mësohet finaliste Kupës së Shqipërisë
28 Shtator, 13:03

Paketa e sigurisë në shkolla, Balla nga Elbasani: Nuk duhet të lejojmë askënd të bëjë biznes me shëndetin e nxënësve
28 Shtator, 08:40

'Të rrisim zbulueshmërinë e akteve kriminale', Balla nga Elbasani: Policia duhet të kontrollojë çdo makinë për armë
27 Shtator, 14:42

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje